**KONTRATA E THEMELIMIT E SHOQERISE TREGTARE**

**"ADEL"SHPK**
**SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR.**

Sot ne date 31 / 03 / 2004 ne qytetin e Korces une pala kontraktuese me cilesine e ortakut te vetem:
1. Adnant Halili,i biri i Muhamet dhe i Trendeline me dt.lindje 12.06.1967,lindur ne Korce dhe banues ne Korce me adrese :L.1,Rr"Mbledhja e Beratit",Nr 43 ,madhor I afte per te kryer veprime juridike,I identifikuar me Pashaporten me nr 0891396 ,date , 27.11.1997 kam rene dakort qe te zhvilloj nje veprimtari ekonomike private nepermjet pasurive time personale ne formen e nje shoqerije tregtare te organizuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe me emertimin "ADEL"SHPK,ne mbeshtetje te ligjes Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare ".

**NENI 1**

Shoqerija me pergjegjesi te kufizuar e lartpermendur eshte person juridik me qender ne Qarkun e Korces,ne fshatin Bulgarec se qytetit Korce dhe me te drejte perfaqesimi ne forme filiali,pjesmarese ne nje shoqeri te dyte apo kontrolluese ne nje shoqeri tjeter ne gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Kjo shoqeri ka per qellim qe veprimtarine e saj ta realizoje ne fushen e Prodhimit dhe tregtimit te Gureve dekorative,import eksport guresh dekorative dhe pajisjesh ne fushen e gureve dekorative dhe materialeve ndihmese.

Objekti,veprimtarija e kesaj shoqerije me pergjegjesi te kufizuar,organizimi si dhe maredheniet e saj ne qarkullimin civil me shtetas shqipetare apo te huaj parcaktohen ne statutin e shoqerise dhe regullohen nga legjislacioni ne fuqi I Republikes se Shqiperise.

**NENI 2**

***Kapitali themeltar I shoqerise.***

Kapitali themeltar I shoqerise tregtare " ADEL"SHPK kap nje vlere prej 100 000 lek.

Pjesa e kapitalit themeltar qe ve ortaku themelues z.Adnant Halili eshte 100 000Lek.

Ne baze te kapitalit te vendosur ne kete shoqeri fitimi do te mbahet 100% nga ortaku themelues.

**NENI 3**

Kapitali baze I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ADEL "SHPK sipas artikullit 2 te kesaj kontrate perfaqeson kapitalin e nevojshem per themelimin e shoqerise tregtare. Kapitali i nevojshm per veprimtarine ekonomike e tregtare te kesaj shoqerije do te trajtohet si kapital investues.

**NENI 4**

Shoqerija tregtare "ADEL" SHPK fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor,Tirane.

Afati I kohezgjatjes se veprimtarise se kesaj shoqerije nuk paracaktohet,por nuk mund te jete me I vogel se 10 vjet.

**NENI 5**

Ne mbeshtetje te ligjes "Per kontabilitetin" pasqyrohet fondi themelor I paleve kontraktuese ku shenohen kapitalet e vena nga sejcila pale kontraktuese ne baze te artikullit 2 te kesaj kontrate.

Fondet ne investime nenshkruhen ne raport me vleren e tyre dhe do ti pergjigjen fazes se aktivitetit sipas mareveshjes paraprake te ortakeve.

**NENI 6**

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar pergjigjet per detyrimet e veta me fondet e saj.

**NENI 7**

Te drejtat e pales kontraktuese jane :

1. te marre pjese ne drejtimin e kesaj shoqerije.
2. te marre pjese ne ndarjen e fitimit te shoqerise ne perputhje me statutin e saj.
3. te mare pjesen perkatese ne pasurine e shoqerise me pushimin e aktivitetit te saj.
4. te pergjigjet per detyrimet e shoqerise ne kufijte e kapitalit fillestar te investuar ne kete shoqeri.

**NENI 8**

Detyrimet e pales kontraktuese jane:

1. te shlyeje kapitalin themeltar te shoqerise per pjesen takuese sipas artikullit 2 te kontrates se themelimit.
2. te marre pjese ne drejtimin e shoqerise sipas statutit.
3. te rruaje sekretet e shoqerise.
4. te veproje me inisiative per realizimin e suksesshem te veprimtarise se kesaj shoqerije me pergjegjesi te kufizuar.

**NENI 9**

Pala kontraktuese ka rrene dakort qe ndarja e fitimeve qe do te rezultojne nga aktiviteti I shoqerise tregtare "ADEL" SHPK pas likujdimit te taksave dhe tatimeve e gjithe shpenzimeve te tjera do te mbahet nga ortaku themelues.

**NENI 10**

Cmimet e sherbimit dhe te blerjeve normalisht do te caktohen nga vete drejtuesit e shoqerise sipas kerkeses dhe ofertes ne treg.

**NENI 11**

Pala kontraktuese,ortak I vetem,eshte dakort qe te gjithe personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerije tregtare,punesimi I tyre do te behet mbi bazen e nje kontrate te vecante ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detrimet ligjore te sejciles pale si dhe paga mujore.

**NENI 12**

Organizimi dhe drejtimi I shoqerise tregtare do te behen sipas statutit te saj mbeshtetur ne dispozitat ligjore qe rregullojne shoqerite tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

**NENI 13**

Te gjitha mosmareveshjet qe nuk do te zgjidhen me mirekuptim ndermjet paleve kontraktuese do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor,Korce.

**ARTIKULLI 14**

Kjo kontrate perpilohet ne 6(gjashte) egzemplare origjinale.

*ORTAKU THEMELUES*

*Adnant Halili*

Adnant Halili

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE KORCE
NOTERI V.M.
Nr 576 Rep.
Nr 217 Kol. lek 2600(2500 lek vlefta e tarifes+ 100 lek vlefta e takses shtetrore,e cila ne formen e pulles,ngjitet vetem ne kop-jen e pare te aktit,qe ruhet,ne arkiv.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot,me 26 mars te vitit 2004,diten e meerkure,para meje noterit VLADIMIR FEHMI MOLLA,antar i dhemes se noterve Korce,qe kryej veprimtarine si noter,ne zyren,qe ndodhet,ne qytetin e Korces,ne rrugen "6 deshmoret",u paraqit qytetari ADNANT MUHAMET HALILI,lindur me 112 qershor,te vitit 1967 ne Korce,banues ne rrugen "MBLEDHJA E BERATIT" nr.43 Korce,madhor,i afte per te kryer veprime juridike,i njohur pr j meje,i cili u shpreh para meje noterit se nenshkrimi i vene ne kontraten e themelimit te shoqerise tregtare "ADEL" shpk,eshte vene prej tij e une noteri se urdheron ligji e vertetoj nenshkrimin e tij.

NOTER
VLADIMIR FEHMI MOLLA